



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 246/24 Dt. 29.03.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

**Procesverbali nga mbajtja e konsultimit publik me qytetarë për
Projekt-Rregulloren për shërbime publike komunale në Komunën e
Prizrenit**

Konsultimi publik me qytetarë është organizuar nga grupi punues për hartimin e Projekt-Rregullores për shërbime publike Komunale në Komunën e Prizrenit.

Njoftimet për qytetarë për organizimin e konsultimit publik janë bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Publikimet janë bërë në webfaqen zyrtare, platëformën e konsultimeve publike si dhe në rrjetin social facebook:

Publikimet janë bërë me **11.03.2024** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/03/Njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-Projekt-Rregulloren-per-sherbime-Shq-Bosh-Tur.pdf>

Në facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/479xXFARiAV6rhZH/?mibextid=oFDknk>

Në platformë:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42340>

Njoftimi si lajm në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-projekt-rregulloren-per-sherbime-publike-komunale-ne-komunen-e-prizrenit/>

Me 21.03.2024, është mbajtur konsultimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e konsultimit:

Në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/u-mbajt-konsultimi-publik-per-projekt-rregullores-per-sherbime-publike-komunale-ne-komunen-e-prizrenit/>

Në facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/ktv7eq3nerEcPmjn/?mibextid=oFDknk>

Konsultimi është mbajtur në sallën e kuvendit komunal (Shtëpia e Bardh) dhe ka filluar në orën 10:10

Hapja është bërë nga Ymer Berisha, udhëheqës i Njesisë për Komunikim me Publikun.

Të nderuar media, përfaqësues të organizatave joqeveritare dhe të gjithë të pranishmit në sallë, kam kënaqësinë që në emrin e kryetarit të komunës, zotit Shaqir Totaj të përshëndes praninë tuaj dhe të përshëndes angazhimin për kontributin që do të jepni në dokumentin e radhës, të cilin e harton komuna e prizrenit, e në këtë rast kemi të bëjmë me shërbimet komunale.

Është një produkt dokument i cili prek në masë të madhe të gjithë qytetarët e komunës së prizrenit, me theks të veçantë operatorët ekonomikë, të cilët zhvillojnë biznes ose aktivitete në qendrat e qytetit, hapësirat publike, pastaj këto hapësira publike po mendojmë si komunë që ti kthejmë në llogari ose në dobi të qytetarit të komunës së prizrenit. Kështu që edhe ky dokument e ka këtë frymë.

Ideja e politikëbërjes në komunë është që së bashku me qytetarët dhe OJQ-të ta ndajnë bashkë autorësinë e hartimit të dokumenteve dhe uroj që të marrin përvojat më të mira. Normalisht dokumenti duhet të jetë në përputhje të plotë me ligjet me të cilat administrohet kjo politikë publike, që janë hapësirat publike në zona urbane dhe ne mendojmë se komisioni ka kryer një punë të mirë, e cila punë do të reflektohet pas votimit të këtij dokumenti në kuvend edhe pas jetësimit ligjor të këtij dokumenti, me qëllimin e vetëm që edhe ne si komunë, edhe qytetarët dhe të gjithë akterët, të cilët janë hisedarë të këtyre politikave publike të kemi konsensus të kënaqshmërisë dhe në këtë mënyrë bashkë, komuna dhe qytetarët të rrugëtojmë drejt aktiviteteve drejt synimit drejt menaxhimit, hapësirave publike, shërbimeve komunale dhe të gjithë bashkë të shkojnë për një jetë më kualitative, më cilësore për veten tonë, familjen se në instancë të fundit edhe kryetari i komunës si lider shipi kemi kërkuar që komisioni ta ketë parasysh që para se me qenë të punësuar në komunë dhe komision, janë qytetarë të këtij kësaj komune me këtë rast do të duhet të ndihen mirë dhe të sjellin një dokument i cili lehtësisht aplikohet dhe zbatohet nga të gjitha palët, të cilat janë të involvuara.

Konsultimi publik do të ketë këtë rrjedhë unë në krahun e majtë timin e kam Rahimin, i cili do ti ti jap disa të dhëna përë dokumentin dhe specifikat që i ka dokumenti .Ne qëllimin e kemi që ky dokument të mbetet në diskutim publik deri me datën 27 mars.

Janë të afishuara dhe e mail adresat ku qytetarët përmes mjeteve të informimit dhe marrin informacionin ,nëse e ndjejnë veten se mund të japin kontribut në këtë fushë. Edhe përmes komunikimit online ne jemi të gatshëm të pranojmë idetë, sugjerimet, vërejtjet apo gjetjet eventuale të cilat mund ti kenë. Qëllimi final është se ky dokument me bashkautorësinë e qytetarëve, OJQ-ve dhe të tjerëve të rrugëtoj drejt kuvendit komunës të merr votën e kuvendarëve, meqenëse kuvendarët vijnë nga parti të ndryshme politike dhe përfaqësojnë grupe të ndryshme të njerëzve dhe qytetarëve. Në këtë mënyrë, në fundin e këtij dokumenti, dokumentit të jetë sa më i përshtatshëm për shfrytëzim sa më racional edhe për ofrim të shërbimeve sa më kualitative. Unë nuk po e zgjas, pasi ta bëjë elaborimin Rrahimi do të keni fjalën secili veç e veç, do të prezantoheni për procesverbal, emër mbiemër, kë përfaqësoni dhe çfarë eventualisht gjetje ose sugjerim i keni parë dokumentit.

Prezantimi i Rregullores është bërë nga Rahim Destani, njëherit edhe kryesues i grupit punues për hartimin e rregullores, duke thënë se: Me propozim të Drejtorisë së Inspektorateve, Kryetari i Komunës së Prizrenit duke thënë se Shaqir Totaj me vendimin nr.01-010/2024 të datës 12.01.2024, ka formuar Grupin punues për hartimin e Rregullores për Shërbime Publike e Komunale.

Grupi Punues ka filluar punën me datë 22.01.2024 dhe ka mbajtur pesë (5) takimi deri në hartimin e draftit të kësaj rregulloreje. Rregullorja për Shërbime Publike dhe Komunale në pjesën më të madhe është përmbajtje e Vendimit Komunal për Rregullimin e Qytetit dhe të Shërbimeve Komunale me nr.01/011-2 i dt.18.11.2004.

Qëllimi i hartimit të kësaj rregulloreje është sepse Legjislacioni i Republikës së Kosovës është ndryshuar si psh. Ligji për Kundërvajtje me nr.05/L-087 ,te dispozitat ndëshkuese që nuk i trajton gjobat më të vogla se 500 euro, si dhe dispozita tjera ligjore në fusha të caktuara e që e ka paraqitur nevojën për ndryshime.

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Në bazë të kësaj Rregulloreje përcaktohen të drejtat dhe detyrat e qytetarëve, kushtet minimale për mbajtjen e pastërtisë dhe higjienës në territorin e komunës, të këshillave shtëpiakë, të vendbanimeve, të ndërmarrjeve, të enteve, të institucioneve, të organeve të administratës, të organizatave politike, të organizatave joqeveritare dhe të subjekteve të tjera, llojet e objekteve të përkohshme (në tekstin në vazhdim objekti i përkohshëm), kushtet dhe procedurat për vendosjen dhe largimin e objekteve në pronën publike, në të cilën Komuna e ka të drejtën e udhëheqjes.

Shërbimet komunale, në vështrim të kësaj Rregulloreje, konsiderohen:

furnizimi me ujë; përcjellja, përpunimi dhe pastrimi i ujërave të zeza dhe atmosferike; rregullimi dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbra publike; pastrimi i sipërfaqeve publike në vendbanime; bartja, deponimi dhe përpunimi i mbeturinave; mirëmbajtja dhe rregullimi i sipërfaqeve publike; mirëmbajtja e ndriçimit publik; mirëmbajtja e varrezave; rregullimi dhe mirëmbajtja e objekteve sportive (të hapura).

Objekte komunale – publike, në vështrim të kësaj Rregulloreje, konsiderohen:

rrjeti i tërësishëm i ujësjellësit dhe kanalizimit, me të gjitha pajisjet; rrugët dhe trotualet; sheshet; hapësirat për parking; sipërfaqet publike të gjelbra; terrenet sportive; varrezat; pajisjet për ndriçim publik; rrjeti i PTK - së dhe telefonat publikë; nyjat sanitare publike; tabelat për shpallje; panotë ndriçuese, reklamat dhe të gjitha objektet tjera, të cilat, sipas destinimit që kanë, mund të konsiderohen objekte komunale.

Objektet e përkohëshme

Vendosja dhe largimi i objekteve të përkohëshme në hapsira publike – me këtë Rregullore përcaktohet baza juridike dhe kriteret themelore për lejimin e vendosjes dhe largimin e objekteve të përkohshme në sipërfaqe publike, llojet e objekteve, mënyra e vendosjes së tyre, si dhe kriteret për përcaktimin e tarifës.

Llojet e objekteve të përkohëshme, sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje janë :

Mbishkrimi (firmat), panotë dhe tabelat reklamuese; Ekranet elektronike reklamuese; Tabelat reklamuese me kinoprojektor, Tabelat reklamuese digjitale, Pllakatet reklamuese, Billboardet, Vitrina të ndriçuara, Panotë murale, Banerët, Kabinat (foltoret) telefonike, Strehët për pritje të autobusëve, Kiosqet (deri më 8m²), Bankomatet (deri më 6m² Kamp-shtëpizat (deri më 8m²).

Objekte të përkohshme lëvizëse, sezonale dhe ekspozuese konsiderohen:

Tavolinat dhe karriget të cilat vendosen në hapësirat pranë lokaleve hoteliere (restoranteve); Pajisjet për shitje të akulloreve, pufkave, misrit, gështenjave, pomfritit, brumërave të ndryshme dhe artikujve të ngjashëm; Automjetet lëvizëse për shitje të ushqimit të shpejtë; Tendat (çadrat) lëvizëse me mekanizëm dhe çadrat e veçanta; Lojërat (lunaparqet, autoparqet, cirqet, ringishpilet dhe poligonet për ngasjen e automjeteve motorike) për fëmijë dhe të rritur; Lojëra të ndryshme për fëmijë dhe të rritur; Gjeneratorët statik për furnizim me energji alternative në hapësira publike; Veturat për ekspozim me qëllim promocioni në hapësira publike; Objekte tjera të pa specifikuar në hapësira publike (veturat e braktisura, pengesa të ndryshme etj).

MBIKËQYRJJA

Mbikëqyrjen e zbatimit dhe respektimit të dispozitave të kësaj rregulloreje e kryejnë organet kompetente të administratës komunale dhe inspektoratet kompetente komunale.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Vendimi Komunal për Rregullimin e Qytetit dhe të Shërbimeve Komunale nr 01/011-2 i dt. 18.11.2004.

Ymer Berisha...

Tani normalisht ne prapë konstatojmë që do të donim që të kemi qytetarë më shumë, por ndoshta dhe muaji i ramazanit që është njerëzit në këtë mëngjes dhe nga syfyri mund të vazhdojë gjumin, po si do që të jetë meqë e kemi të pranishme mediat dhe ky konsultim transmetohet drejtpërdrejtë dhe mund të ndiqet në edicionet e lajmeve. Po them që dokumenti do të shkojë drejt familjeve të qytetit të prizrenit, komunës së prizrenit dhe mundësia e komunikimit online mbetet e hapur deri më datën 27 mars. Kështu që tani me ngritje dore kush do të merr fjalën të deklaroheni me emër e mbiemërdhe kë përfaqësoni, këto të dhëna na duhen për procesverbal. Kontributi i juaj pastaj do të publikohet në faqet komunës së Prizrenit. Këto praktika dhe këto kërkesa jemi duke i jetësuar me të vetmin qëllim që një herë e mirë ta kuptojmë, komuna udhëhiqet nga të gjithë ne, të gjithë jemi të barabartë para ideve, sugjerimeve, vërejtje, gjetjeve me qëllimin e vetëm që së bashku me qytetarët dhe komuna të rrugëtojnë në jetë të gjatë dhe të besuar në njërin tjetrin dhe të shkojmë drejt përmirësimit të cilësisë së jetës.

Bashkim Gashi, qytetar sëpari përgëzimi do të thotë iniciativën dhe punën që e ka bo grupi se sa e pash është njëra ndër rregulloret ma voluminoze dhe që përfshijnë lami thua për gjithë qytetarët

e komunës së Prizrenit ku secili në një mënyrë gjatë jetës ose veprimtarisë së vetë do të ballafaqohet me dispozitat e kësaj rregullore.

Por mos më zgjat me këtë, një një lexim do të thotë shpejt që e bona, kam disa pyetje dhe propozime konkrete, në Nenin 6 dikon shkrun në bazë të këshillit të këshillit urban, aty sigurisht nënkuptohet ajo, puna e këshillave që janë në lagjet ose në fshatra. Është çështja e kërkesës që të vërtetohet, shiqohet cilësia e ujit. Mendoj që duhet hiqet ajo këshillit urban se tash duhet të mbledhni një organ për me bo ni kërkesë në rast se dyshohet që uji nuk është i pijshëm. Besoj që duhet të jetë vetëm bazë të banorëve, banorëve të lagjes ose e lagjeve urbane ose të fshatrave. Edhe tjetra nga nenin 6.4 mendoj që duhet shtohet, ndërmarrja publike, ndërmarrja e cila kujdeset do të thotë për furnizim me uji, është obligim që të njoftojë për cilësinë e ujit.

Qytetarët shpesh herë ajo (ndermarrja) i njofton për cilesin e ujit mirëpo në dispozitat e kësaj rregulloreje nuk e pash të jetë e rregulluar që ajo ti njoftojë për cilësinë e ujit. E kam fjalën kur uji është i papijshëm dhe sa ajo situatë duhet të zgjatë edhe kohën kur uji veç mund të përdoret.

Mandej në nenin 59 thotë për shitjen e mallrave në trotuar e thotë ndalohet përveç kur të jepet leja për shitje dhe ekspozimin e mallrave kur të jepet leja organi komunal për këtë gjë. Mendoj se në zonën historike duhet precizohet, sepse në zonën historike edhe ashtu trotuaret janë të ngushta, duhet ndalohet shfrytëzimi i hapësirave publike. do të thotë ekspozimi edhe shitja e produkteve ndryshme, pasi që këto janë të parapame me ligjin për zonën historike, që mendojë se edhe kjo rregullore nuk duhet që të bie ndesh me Ligjin në fuqi. Gjithashtu edhe reklamat të cilat vendosen edhe firmat cilat vendosen duhet të jenë në përputhshmëri me këtë ligj mbi mbrojtjen e zonës historike të komunës së Prizrenit. Aty janë të vendosura edhe specifikat si: madhësia e reklamës, materialet të cilat duhet të përdoren e kështu me radhë.

Diku shkruan në nenin 72, për kabinat telefonike, s'di tash sa jan në përdorim e di që ndoshta ato kanë mbet nga ndonjë rregullore e vjetër, mendoj që teknologjia e ka ba të veten dhe i ka hek këto kabina, nuk e di që ka mbet ndonjë përpos një kabine telefoni mendoj në Prizren, ndoshta inspektorët e din ma mirë. Është një telefon, ndoshta ajo mund të jetë ashtu si përkujtim i të kaluarës mos të hiqet po.... kabina tjera s'dija a ka, s'kam pa kabina telefonike ndoshta kish me e kujtue atë kohë, gjithashtu edhe për kiosqet mendoj që aty shkruan që duhet të jetë në formë dhe dizajn dhe material të veçantë. Por për zonën historike mendoj që duhet parashihet edhe të jenë në bazë ligjit, kështu që mos të jenë si ato të tjerat por të të përshtaten. Një problem që ka me dal, tash se di qysh zgjidhet, kisha kërkuar ndoshta edhe informacion kompetentëve do të thotë të inspektoriatit. Tani e dimë që në shatërvan dhe rrugët tjera që përbëjnë zonën historike, vendosja e këtyre njësorëve të energjisë elektrike a ka ndonjë model të veçantë apo ka me u vendos sipas standardeve. Janë objekte të cilat duhet më u vendos dhe kjo rregullore që po hartohet duhet ndoshta me vendos për formën dhe vendet ku kanë me u vendos pasi së shpejti do të kryhen punimet.

Ymer Berisha-A kemi folës Bashkim, falemnderit shumë për kontributin. Sigurisht që këtu kemi jo një por një numër të konsiderueshëm të kompetentëve dhe komisioni dhe në inspektorat. Do të marrin gjitha vërejtjet dhe ato që kanë hapësirë për inkorporim absolutisht me besim më të madh do të inkorporohen.

E kemi të qartë ,Rahimi e përmendi ,domethënë aty ku ligj për një hapësirë publike, krejt kjo rregullore do i subordinohet, forca e ligjit është më e madhe se sa një rregullore, ose ni akti tjetër që e nxjerr komuna, kështu që ne jemi të vetëdijshëm se kjo rregullore duhet të jetë me patjetër në përputhje me me ligjin për zona mbrojtjes, ose ligjin për qendrën e qytetit Prizrenit.

Simon Veseli -Unë po ju përshëndes ju organizatorët e këtij takimi me qytetarët, unë e kam parë në faqen e kuvendit që keni postu edhe këtë rregullore. Zotëri Gashi para folësi ishte pajtuar plotësisht me diskutimin e tij. Ishte me vend, po e kam vetëm një propozim për mos mar kohë ju mërzi shumë se shpesh po më kritikonin se po flet pak si shumë ,mirë.

Më fol pak se dija mund të thamë shumë. Po kam një propozim ju e dini që të gjithë na e vërtetë e dimë që janë themelu këshillat lokale nëpër terrene. Mos pjesëmarrja e kryetarëve të këshillave në kesi debate, që është në interesin e çdo qytetari, pom shkon mendja që nuk janë mirë të informum jo pse ka ngel e që është faji te institucioni që e ka përgatit këtë debat,por që shumë njerëz nuk janë përdorues të rrjeteve sociale e interneteve mendoj dhe propozoj që për kesi lloj debati edhe për këtë lloj vendimi që është në interesin e gjithë qytetarëve është mirë jo vetëm drejtorja që sot na ka thirr, por prej kryetarit dhe çdo drejtori, me pas me bashkëpunu pak më afër me kryetarët ose me këshillet lokale me jau dergue ka një letër e me i thirr. Besoj se kuvendi komunal ka mundësi që projektin që e keni publiku përmes rrjeteve të internetit më ja u dërgue kryetarëve përmes udhëheqesave të zyrave te vendit që keni nëpër teren e me i informue që pastaj kryetari me i informue qytetarët për keso lloj projekte. Edhe në informacion i vogël më tej përmes këshilltarëve lokalë shkon deri tek qytetari, sepse shumica e qytetarëve nuk besoj që e dinë këtë rregullore që është shumë e shumë me interes, edhe shumë e dobishme që qytetarët me qenë ma të përgatitun më të informum, prandej është mirë ta sensibilizojmë këtë punë kaq të mirë që jena tu e bo, por kjo, krejt ky angazhim duhet të mbërrijë deri te qytetari.

Domethënë këtu është qëllimi që qytetarët me i vetëdijësu, por edhe me u njoftu me të vërtetë për gjitha rregullat që i bjen Asambleja komunale e Prizrenit, unë ju dëshiroj sukses dhe punëtë mbar.

Ymer Berisha, Simon, faleminderit për kontributin edhe Rahimi nëse ka ndonjë përgjigje ,ftohen pastaj edhe folës tjerë që janë të gatshëm me marrë fjalën e që janë të pranishëm këtu me ne. Ta dëgjojmë tash pak Rahimin qka na thotë.

Rahim Destani---Faleminderit zotni sa i përket rregullores, lidhur me qendrën historike, kryesisht për sheshin shatërvan në neni 167 ,në zonën historike të qytetit të Prizrenit vlejnjë dispozitat ligjore në fuqi të ligjit për qendrën historike të Prizrenit. Asnjë punë nuk kryhet në zonën historike të Prizrenit pa pëlqimin e QRTK-së, dhe të Këshillit për Trashëgimi Kulturore, varësisht prej rolit që kanë.

Kiosqet, vetëm është paraparë modeli edhe infrastruktura ligjore në hapësira publike është një projektet duke zhvilluar në komunë që kanë me i caktuar lokacionet e reja në qytet. Sa i përket njësorëve elektrik që kanë me u vendosur, ato me aprovimin e qendrës rajonale e trashëgimisë kulturore ,këshilli trashëgimisë, me lejen e e urbanizmit duhet me vendos ,formën e cakton drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor. Ata japin leje për këto lloj punimet që kryhen në sheshin e shadervanit. Uji kryesisht kontrollohet prej institutit për shëndetësi , mostrat e analizat bëhen atje me kërkesën e zyrtarëve kormal, por inspektorët sanitarë, fatkeqësisht nuk i kemi më këtu pasi që një pjesë janë transferuar në agjenci, mirëpo komuna duhet patjetër me i marr modhe me i dërgue në institut për me e kontrollue cilësinë e ujit dhe garantimin e ujit të pijes, për shkak se na jemi për qytetarët edhe duhet me bashkëpunu me qytetarët dhe me mbrojt interesin dhe shëndetin e qytetarëve të prizrenit, faleminderit.

Ymer Berisha-Falemnderit marrim dike folës tjetër nga qytetarët, pastaj i përgjigjem, me plotësue hajde dashe po.

Dashuri Memçaj- Përshëndetje për të gjithë, unë vetëm desha ta plotësoj përgjegjen e Rahimit kur është në pyetje zonae qendrës historike të qytetit. Me sa e di unë të gjitha këto shtyllat elektrike që janë të vendosura do të futen nën tokë dhe automatikisht njëhisorët e rrymës duhet të largohen, me siguri e kanë ndonjë formë tjetër të vendosjes së tyre, e jo në shtylla të elektrike kaq pikë.

Lulzim Gashi, Unë ju përshëndes gjithë të pranishmit. Ne këtu jam pronar i kompanisë autobartje Luli në Prizren edhe e pash përmes rrjeteve sociale se është takim për qytetarë. Unë e kam një shqetësim sepse është bash tema e për shërbime publike. Për autobartje është një kompani që favorizohet që 22 vite me thanë të drejtën dhe e ka një ligj të veçantë edhe kohën e veçantë diçka që e ka çmimin e garantueme prej 35 euro, kurse çdo gjë që është e regjistruar në Prizren kanë thirrur në shërbimin 25 euro maksimum . Edhe desha të ndërlidhem rreth temës se unë e kam apliku e herën e kalume dhe është kërku ni diçka e veçantë që me pas përvojë pune së paku 5 vite me institucionet shtetërore. Desha me e ba këtë pyetje rreth kësaj të jemi ku muaj me i bo unë 5 vite përvojë se unë jam duke punuar që 7 vite me këtë veprimtari,pasi që vetëm një kompanie i jepet tenderi për këtë veprimtari. E drejta për me bashkëpunu me punë. U prishen deri herën e kalume,Ishte zoti krasniqi drejtor edhe pash se ka të bëjë me shërbime publike,në kushtet e tenderit e kanë shkruar si diçka e veçantë për kamion me e pas patent me kategorinë D, çka hznë në punë kjo për kamion.

Ymer Berisha, tash ky debati, unë u konsultova me Rrahimin nuk kemi ne ndonjë përgjegje që mund të japim ky forum që jemi këtu, po na e regjistrojmë shqetësimin dhe absolutisht e përcjellim të drejtoria adekuate që e organizon këtë bartje ose këtë shërbim dhe thjesht ne të ftojme si leadership i komunës ,nëse mendon se ai është organizatë në nivel kosove dhe mbi baza ligjore,nëse komuna jonë ka diçka që nuk përmbushet ju ftojme që të jemi bashkë dhe ta rregullojmë.

Lulzim Gashi, kur kena marrë pjesë në tender nuk është këqyrë çmimi më i lirë te disa kompani nuk është këqyr çmimi, kush është më e lirë vetëm të dokumentacionet e ka pas kompania në fjalë një plus pse ka edhe kategori të patentës D në letra realisht u kërku shërbim me kamion për vetura me bajt nëpër qytet, për ato unë jam shqetësuese se unë paguaj taksa ,jo unë po edhe shumë tjerë

që kanë kësi lloj shërbime ,ndërlidhet pikërisht me këtë dikaster, për shembull shërbimet publike.,mirëpo është një çmimi garantum i pronorit X fjalë që e ka marr tenderin për me transportu deri në 35 euro, kurse çdo kompani që thjesht privatisht e thirr çmimi është 25 deri 30euro në maksimum. Edhe pse është ngritë më herët çmimi i naftës është shkue deri në 1.80 euro,kurse këta as nuk dihet dihet çmimi se a është më larg me kilometra ose më afër. Unë e kom pas një përvojë ndoshta mue mu ka marr mjeti në qytet.

Ymer Berisha-Faleminderit bazën e kuptova se çfarë është kërkesa ,vetëm se unë po them publikisht jemi në televizion, Ligji i prokurimit është strikt në secilën politikë publike. Nëse ju si operatorë ekonomikë vëreni se nuk po përmbushin kërkesat ligjore, na drejtoheni dhe jemi të gatshëm bashkë me ju ta bëjnë më të mirën për krejt qytetar. Barabarësia para ligjit dhe para tenderëve duhet të jetë e njëjtë. Mirëpo ne nuk mund ti diskutojmë sot specifikat që ju po i përmendni çmimin, lartësinë e tjera. Këto ligje po na bashk me ju, kemi vullnetin që ta bëj më të mirën për të gjitha palët. Falemnderit sido që t'ia falë ndershëm dikush tjetër.

Duket se nuk kemi folës tjetër apo,atëherë edhe ne më lejoni që në emër të kryetarit komunës do të ju falënderoj të gjithë ju që jeni të pranishëm, të falënderoj të gjithë qytetarët për kontributin e tyre. Jemi të hapur për vendimmarrjet së bashku me qytetarët. Nuk do të jetë dokumenti i fundit që nxjerrim në konsultim publik,do të rrugëtojmë me hartim të dokumenteve, politikave publike dhe ditëve dhe javëve në vazhdim deri në qëllimin final. E jona është me bashkëbisedu me ju dhe të ndërtojmë një partneritet të besimit. Komuna është e qytetarëve, qytetarët janë të komunës. Edhe të rrugëtojmë drejt jetës më të mirë, cilësisë së jetës më të mirë për ne dhe familjet tona. Shërbimet janë për të gjithë ne dhe ne veç si komunë si lidërsip e kemi këtë kufizim. Detyrimi i parë dhe i fundit është zbatimi i ligjshmërisë dhe jemi duke bërë më të mirën të mundshme në këtë drejtim. Ligji, ne qytetarët ,shkojnë drejt sukseseve të reja ,faleminderit.

Konsultimi ka përfunduar në orën 10:35.

Videon e mbajtës së konsultimit mund ta gjeni në këtë vegëz:

<https://www.facebook.com/share/v/w2bvfppezJY3jDcS/?mibextid=oFDkn>

Procesmbajtës: